

VENDIM
Nr.6, datë 27.2.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtar i “ “
Veli Budo,	Anëtar i “ “
Zija Vuci,	Anëtar i “ “
Franc Jakova,	Anëtar i “ “
Alfred Karamuco,	Anëtar i ““
Hilmi Dakli,	Anëtar i “ “

me sekretare Drita Filto, me datën 30.1.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8 Akti që i përket :

K Ë R K U E S : ABDYL KALEMI, i përfaqësuar nga Av.Natasha Xhacka.

SUBJEKTE TË INTERESUARA :

1. DYLBER KALEMI, i përfaqësuar nga Av.Florë Biba.

2. PROKURORIA E PËRGJITHSHME, e përfaqësuar nga Z.Halil Kopani.

OBJEKTI

Njohja dhe garantimi i së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor dhe anulimi i vendimeve nr.3207, datë 2.11.1994 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.648, datë 21.2.1996 të Gjykatës së Kasacionit Tiranë, në bazë të neneve 24/a, 10 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 dhe nenit 38, 39 dhe 40 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësueses së kërkuarit dhe të palëve të interesuara dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuari pretendon se zhvillimi i gjykimit në Gjykatën e Apelit, është bërë pa u njoftuar dita me shpalljen e listës në kohën e duhur. Për pasojë ai pretendon se nuk pati mundësi të paraqitej vetë ose të përfaqësohej me anën e një avokati ditën e caktuar në gjykimin e çështjes për të paraqitur fakte të reja që eventualisht mund të dispononte dhe të bënte pretendimet e tij, gjë që përbën një shkelje të parimit të shprehur në ligjin kushtetues për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor (nenet 38,39 e 40 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993). Përveç kësaj, kërkuari pretendon se si pasojë i është cënuar e drejta e tij për ankim, parashikuar nga neni 13 i ligjit të sipërpërmendur.

Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen dhe vlerësoi faktet, arriti në konkluzion se Gjykata e Apelit, me shtesë liste, ka bërë njoftim duke zbatuar rregullat e vendosura nga kjo Gjykatë. Ndonëse u konstatua se disa veprime të Gjykatës së Apelit, si tërheqja e dosjes nga gjykata e faktit nga një anëtar i saj ose gjykimi i çështjes me një mënyrë të përsheptuar, nuk gjejnë justifikim as me natyrën dhe rëndësinë e çështjes, as me karakterin urgjent të saj, Gjykata Kushtetuese çmon se të gjitha këto veprime të parregullta nuk krijojnë bindjen dhe nuk shërbejnë si bazë për prezumim se Gjykata e Apelit nuk ka bërë njoftimin e duhur.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata konstatoi se vendimi i Gjykatës së Apelit ka një të metë me rëndësi. Në këtë vendim, në pjesën arsyetuese, thuhet përveç të tjerash se: "Gjykata pasi dëgjoi palët... vendosi...", gjë kjo që len të kuptohet se gjykata vendimin e saj e ka mbështetur në faktet e administruara në gjykatën e shkallës së parë dhe në analizën e pretendimeve të palëve, ndërsa gjatë gjykimit u provua se as palët as përfaqësuesit e tyre nuk kanë qenë të pranishëm në gjykimin e çështjes. Kjo parregullsi në vendimin e Gjykatës së Apelit nuk është formale dhe sipas pikëpamjes së disa anëtarëve përbën një shkelje të parimit të konsakruar nga neni 38 i ligjit nr.7692, datë 31.3.1993, por që nuk u përkrah nga shumica e kërkuar nga neni 26 i ligjit nr.7561, datë 29.4.1992.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. në mbështetje të ligjit nr.7561, datë

29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese, me shumicë votash.

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë, më datë 27.2.1997